



Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu: Diplomacia shqiptare, dimension i ri për industrinë ushtarake dhe sigurinë rajonale



» faqe 3



SHEFI I SHTABIT ARBEN KINGJI PRITI KOMANDANTIN E KFOR-it, GJENERALMAJOR ENRICO BARDUANI

Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, gjatë një takimi me komandantin e KFOR-it...

» faqe 4



PUTHJA E NËNËS NË UNIFORMË: SAKRIFICA E HESHTUR NË FILLIM TË VITIT SHKOLLOR

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Çdo shtator, oborret e shkollave mbushen me zhurmën e gëzueshme të fëmijëve që nisin vitin e ri shkollor. Prindërit i shoqërojnë...

» faqe 7



TRE YJE QË NUK PERËNDOJNË KURRË

Ka momente kur fjala hesht, kur shkrimi ndalon, sepse përballë sakrificës së jetës, gjithçka tjetër merr një hap mbrapa. Në radhët e Forcave të Armatosura, janë shkruar faqe nderi me emra që nuk do të fshihen kurrë nga kujtesa. Major Klodian Tanushi, nëntetare Zarife Hasanaj...


» faqe 8

Kryeministri Rama, ministri i Mbrojtjes Vengu dhe shefi i Shtabit Kingji, në takime me Admiralin amerikan Munsch: Rilindja e industrisë ushtarake, siguria rajonale dhe partneriteti strategjik me SHBA

Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim me Komandantin e Forcave Detare të Shteteve të Bashkuara në Europë dhe Afrikë, Admiralin Stuart B. Munsch. Takimi u zhvillua në kuadër të hapave që Shqipëria po ndërmerr për rilindjen e industrisë ushtarake, si dhe për ecurinë e projekteve madhore si Korridori VIII dhe Porti i Ri i Durrësit.

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, në këtë takim theksin e vuri mbi thellimin e bashkëpunimit strategjik në fushën e mbrojtjes, si dhe mbi përfshirjen e Shqipërisë në projekte të përbashkëta të sigurisë dhe mbrojtjes rajonale.

Në vijim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, u fokusuan mbi zhvillimet në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, situatën e sigurisë në rajon dhe



forcimin e bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjenerallejtënant Kingji nënvizoi rolin thelbësor të pranisë së KFOR-it në Kosovë si garanci për sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë rajonal, duke e konsideruar këtë mision të pazëvendësueshëm. Ai vlerësoi mbështetjen e SHBA-ve, sidomos përmes partneritetit të qëndrueshëm me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit.

Nga ana e tij, Admirali Stuart B. Munsch vlerësoi rolin konstruktiv të Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura si faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon dhe më gjerë, si edhe kontributin e trupave tona në misionet e NATO-s, veçanërisht në Kosovë.

Gjatë vizitës së tij njëditore në vendin tonë, Admirali Munsch zhvilloi takime edhe me Komandantin e Forcës Detare, nënadmiral Adnand Agastra.



Në një ceremoni të veçantë të zhvilluar në Ministrinë e Mbrojtjes, së bashku me komandantët e Forcave dhe ekipin drejtues të Ministrisë, u përshëndet Kapiteni Eric Cote, me rastin e përfundimit të detyrës së tij si atashe ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri.

Gjatë mandatit të tij, Kapiteni Cote ka luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e partneritetit ushtarak mes Shqipërisë dhe SHBA. Në këtë periudhë, skuadra e Bashkëpunimit Ushtarak pranë Ambasadës së SHBA-së në Tiranë, si dhe pesë këshilltarët amerikanë të integruar në Ministrinë e Mbrojtjes, kanë dhënë një kontribut të vyer në modernizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në përshëndetjen e tij, drejtuesit e Ministrisë së Mbrojtjes shprehën mirënjohjen për Kapitenin Cote, për profesionalizmin, dashamirësinë dhe përkushtimin e treguar gjatë gjithë kohës së shërbimit në vendin tonë,

Ceremoni mirënjohjeje për atasheun ushtarak amerikan: Një kapitull i ri në partneritetin strategjik



duke theksuar se partneriteti me SHBA-në mbetet i pazëvendësueshëm për sigurinë dhe mbrojtjen e Shqipërisë.

“Mirënjohës Eric-ut për dashamirësinë

dhe përkushtimin e tij në forcimin e partneritetit tonë strategjik me SHBA. Thank you, Eric!” – u theksua në mesazhin e lamtumirës.



Ministri i Mbrojtjes Vengu: Diplomacia shqiptare, dimension i ri për industrinë ushtarake dhe sigurinë rajonale

Në një kohë kur mbrojtja dhe diplomacia janë të ndërthurura më fort se kurrë, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, mbajti një fjalë të posaçme përpara ambasadorëve shqiptarë në botë, gjatë takimit të zhvilluar në Tiranë.

Në fjalën e tij, ministri theksoi se rilindja e industrisë ushtarake shqiptare përbën një nga prioritetet madhore të qeverisë, duke e cilësuar si një sektor strategjik që do të ndikojë drejtpërdrejt jo vetëm në forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes, por edhe në rritjen e rolit ndërkombëtar të vendit tonë.

“Modernizimi i kapaciteteve të luftimit është një domosdoshmëri përballë kërcënimeve të reja të sigurisë. Kjo kërkon jo vetëm investime në teknologji dhe pajisje, por edhe një ndërveprim të vazhdueshëm me aleatët tanë strategjikë”, - u shpreh ministri.

Ai shtoi se kërcënimet hibride, sfidat e sigurisë kibernetike dhe teknologjite e avancuara po ndryshojnë mënyrën se si shtetet duhet të organizojnë mbrojtjen e tyre, duke e bërë të domosdoshme një qasje gjithëpërfshirëse, ku diplomacia luan një rol po aq të rëndësishëm sa edhe forcat e armatosura.

Ministri Vengu theksoi gjithashtu se ambasadorët shqiptarë duhet të jenë zëri i ri i diplomacisë së mbrojtjes, duke përçarur tek partnerët ndërkombëtarë rolin e Shqipërisë si faktor sigurie në Evropën Juglindore. “Detyra juaj është të bëni të njohur kontributin e



Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut, pjesëmarrjen tonë në misionet paqeruajtëse dhe mundësitë e reja që hap rilindja e industrisë ushtarake për bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar”, - u shpreh ai.

Duke iu referuar kontekstit rajonal, ministri

nënvizoi se Shqipëria mbetet e përkushtuar për stabilitetin dhe paqen në Ballkanin Perëndimor, duke e parë partneritetin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n si garancinë kryesore për sigurinë kombëtare dhe rajonale.

Fjala e ministrit u përmbyll me një apel të qartë: “Mbrojtja dhe diplomacia nuk janë më dy fusha të ndara. Ato duhet të ecin paralelisht, të përforcojnë njëra-tjetrën dhe të bëjnë Shqipërinë një aktor më të fortë në skenën ndërkombëtare.”

Shefi i Shtabit Arben Kingji priti komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Barduani

Shefi i Shtabit të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, gjatë një takimi me komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Barduani, shprehu vlerësimin e tij për drejtimin e suksesshëm të misionit, me rastin e përfundimit të mandatit të tij.

Gjatë takimit u diskutuan një sërë çështjesh që lidhen me angazhimin e vazhdueshëm të KFOR-it për forcimin e sigurisë në Kosovë dhe ruajtjen e stabilitetit rajonal. Gjeneralmajor Kingji ritheksoi angazhimin e vazhdueshëm të Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura në përmbushjen e detyrimeve në këtë operacion të rëndësishëm të NATO-s, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për sigurinë dhe paqen në rajon.



EOD, në vijën e parë të mbrojtjes së jetës së qytetarëve


Vazhdon me intensitet puna e efektivëve të Kompanisë EOD të Batalionit të Xhenios, të angazhuar në pastrimin e territorit nga municionet e identifikuar në disa bashki të vendit, mes tyre Tiranë, Vorë, Mirditë dhe Dibër.

Ekspertët e specializuar të EOD, falë kualifikimit profesional dhe përvojës së fituar ndër vite, po kryejnë me përkushtim procesin e vlerësimit të municioneve të kalibrave të ndryshëm, duke vijuar më pas me transportimin dhe asgjësimin e tyre në mënyrë të sigurt.

Ky mision i vazhdueshëm i Forcave të Armatosura është një kontribut i drejtpërdrejtë për mbrojtjen e jetës dhe pronës së popullsisë civile, si dhe për garantimin e sigurisë në zonat, ku ende hasen gjurmë të municioneve të mbetura nga e kaluara.



KONTINGJENTI XVII E O D FORCAT E ARMATOSURA WEARENATO



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Forca e mbrojtjes dhe madhështia e respektit
Shpeshherë, në vorbullën e përditshmërisë, fjalët që kalojnë pranë nesh marrin formën e këshillave të harruara. Ato duken si thënie të zakonshme, të cilat, sapo i lexojmë, rrëshqasin e treten. Por ka disa shprehje që nuk mund të kalojnë pa lënë gjurmë. Njëra prej tyre është: “Mbroni ata që janë pas jush dhe respektoni ata që qëndrojnë përkrah jush”.

Ky është një urdhër i heshtur i jetës për mënyrën si duhet të qëndrojmë në marrëdhënie me njerëzit dhe me botën që na rrethon.

Një shprehje që në thelb nuk flet vetëm për solidaritetin, por edhe për ndërgjegjen, për përgjegjësinë dhe për etikën e një shoqërie që synon të quhet humane.

Mbrojtja e atyre që janë pas nesh

Të mbrosh atë që është “pas teje” nuk do të thotë domosdoshmërisht të kesh dikë fizikisht pas shpine. Mbrojtja është një detyrim moral.

Po ne si shoqëri e “gëzojmë” këtë ndjesi ?? Mbrojtja është barrikada që ngrihet mes të fortit dhe të dobët, mes padrejtësisë dhe të drejtës, mes harresës dhe kujtesës.

Nëse ne nuk mbrojmë ata që janë pas nesh, atëherë kush do t'i mbrojë? Nëse shohim vetëm veten, duke ecur përpara pa kthyer kokën, atëherë çfarë vlere ka ecja jonë?

Një komb matet jo nga luksi që arrin për të pasurit, por nga kujdesi që u jep më të pambrojturve. Mbrojtja nuk është thjesht akt individual, por është edhe një parim shoqëror e politik: të mbrosh do të thotë të krijosh ligje të drejta, institucione që funksionojnë, një kulturë kolektive të solidaritetit.

Respekti për ata që janë përkrah nesh

Respekt për ata që janë “përkrah nesh”. Nuk flasim për largësira, për ata që janë të harruar apo të padukshëm. Flasin për njerëzit e përditshëm që ecin krah për krah me ne: familjarët, miqtë, kolegët, bashkëpunëtorët, fqinjët, qytetarët që takojmë çdo ditë. Respekti nuk është formalitet. Nuk është përshëndetje e thatë në rrugë, as buzëqeshje e shtirur në tryeza zyrtare. Respekti është pranimi i tjetrit si të barabartë, është dëgjimi i mendimit të tij, është njohja e të drejtës së tij për të qenë ndryshe. Respekti është të mos e përdorësh tjetrin për interesin personal, të mos e nënvlerësosh, të mos e poshtërosh.

Në një shoqëri ku respekti mungon, marrëdhëniet shndërrohen në tregti interesi, e lidhjet njerëzore humbasin ngjyrën. Përkundrazi, aty ku ekziston respekti, ka mundësi për bashkëpunim, për zhvillim, për paqe të brendshme e të jashtme. Respekti është ura që lidh individët në komunitet.


Balanca midis mbrojtjes dhe respektit

Mbro ata që janë pas teje dhe respekto ata që janë pranë teje. Një shoqëri që mbetet vetëm tek mbrojtja, pa respektin e përditshëm, rrezikon të bjerë në hipokrizi. Po ashtu, një shoqëri që flet vetëm për respekt të ndërsjellë, por nuk mbron të dobëtin, është një shoqëri e padrejtë dhe e pashpirt.

Vetëm balanca mes këtyre dy shtyllave mund të krijojë një kulturë të shëndetshme shoqërore.

Në realitetin tonë shqiptar, kjo thënie vjen më aktuale se kurrë. Shpesh kemi parë se si të fortët përfitojnë mbi të dobëtit, se si ligjet nuk arrijnë t'i mbrojnë ata që nuk kanë zë. Shpesh kemi parë mungesën e respektit në çdo hap, në politikë, ku kundërshtari shihet si armik, në rrugë, ku një shofer i papërgjegjshëm nuk e sheh këmbësorin si njeri, në familje,

“Mbroni atë që është pas jush dhe respektoni atë që është përkrah jush!”



ku harrojmë t'i kushtojmë kohë njëri-tjetrit.

Prandaj kjo shprehje është si një thirrje alarmi, një pasqyrë ku duhet të shohim fytyrën tonë dhe të pyesim veten: a po mbrojmë ata që janë pas nesh?

A po respektojmë ata që janë pranë nesh?

“Mbroni atë që është pas jush dhe respektoni atë që është përkrah jush” nuk është vetëm një këshillë morale, është një formulë e jetës së drejtë, një program i thjeshtë, por i madh, me një sy të kthyer pas, për të mbrojtur ata që kanë nevojë për ne, dhe me një sy të kthyer anash, për të respektuar ata që ndajnë udhën me ne.

Nëse arrijmë t'i bëjmë këto dy gjëra, atëherë jeta jonë fiton një qëllim më të lartë, shoqëria jonë merr formë më njerëzore, dhe historia jonë shkruhet me më shumë dinjitet.

Respekti nuk është luks, por domosdoshmëri

Respekti i titullarit ndaj vartësit nuk është thjesht sjellje e mirë, por është kusht i domosdoshëm për funksionimin e një administrate të shëndetshme dhe të drejtë. Nëse drejtuesit nuk kuptojnë këtë, atëherë asnjë strategji, reformë apo plan veprimi nuk ka për të sjellë frytet e dëshiruara.

Një institucion është aq i fortë sa është i drejtë dhe i respektueshëm brenda vetes.

Një vartës i respektuar nuk është vetëm i kënaqur në vendin e punës, por është edhe më produktiv. Respekti është forma më e fuqishme e motivimit. Ai i kthen punonjësit nga ekzekutorë të urdhrave në bashkëpunëtorë të vërtetë, që japin ide, marrin përgjegjësi dhe kontribuojnë realisht për ecurinë e institucionit.

Ky është mesazhi që duhet të mbajmë me vete çdo ditë: mbrojtja është akt force, respekti është akt madhështie.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Familjet ushtarake mes emocioneve të shkollës dhe detyrës ndaj atdheut

Çdo shtator, oborret e shkollave mbushen me zhurmën e gëzueshme të fëmijëve që nisin vitin e ri shkollor. Prindërit i shoqërojnë me krenari, mësuesit i presin me përqafime dhe librat e rinj hapin rrugën e dijes. Por për disa familje, kjo ditë ka një emocion të veçantë, për familjet e ushtarakëve. Në një mëngjes të tillë, një puthje në ballë nga një nënë në uniformë nuk është vetëm gjest dashurie, por edhe simbol i një sakrifice të heshtur që shoqëron çdo hap të fëmijës drejt shkollës.

Nëna ushtarake, mes uniformës dhe amësisë

Figura e nënës ushtarake është një nga më të fuqishmet që mund të shfaqen në shoqërinë tonë. Ajo përballet me një sfidë të dyfishtë, të jetë nënë e përkushtuar për fëmijët e saj dhe njëkohësisht mbrojtëse e atdheut. Ky rol i dyfishtë nuk është i lehtë. Shumë herë, nënat ushtarake nuk mund të marrin pjesë në ceremoni shkollore, mbledhje prindërishe apo momente të rëndësishme familjare, pasi detyra i thërret në stërvitje, shërbime apo misione. Megjithatë, një gjë mbetet e pandryshuar, dashuria e tyre e pakushtëzuar. Një puthje në ballë, një përqafim para se fëmija të hyjë në klasë, janë çaste që mbartin forcën dhe ngrohtësinë e një pranije të pashlyeshme.

Fëmijë që rriten me krenari dhe disiplinë

Fëmijët e ushtarakëve nuk janë thjesht nxënës të zakonshëm. Ata rriten me një ndjenjë të hershme përgjegjësie dhe krenarie. Që të vegjël, ata mësojnë se prindi i tyre është i thirrur për diçka më të madhe se vetja: për mbrojtjen e vendit.

Kjo i bën ata të kuptojnë ndryshe edhe shkollën. Për ta, librat nuk janë vetëm mësim, por edhe një mjet për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt. Uniforma e prindërve u mëson se disiplinën dhe sakrificën nuk i mbart vetëm ushtria, por edhe jeta e përditshme.

Gruaja shqiptare në uniformë, heroizëm i dyfishtë

Në shoqërinë tonë, figura e nënës shpesh shihet e lidhur me shtëpinë dhe kujdesin për familjen. Por gruaja shqiptare në uniformë e tejkalon këtë imazh, duke treguar se mund të jetë njëkohësisht nënë e dhembshur dhe ushtarake e pathyeshme.

Ky heroizëm i dyfishtë është një frymëzim jo vetëm për fëmijët e saj, por për gjithë shoqërinë. Ajo dëshmon se dashuria nuk është pengesë për sakrificën, dhe se përkushtimi ndaj familjes mund të bashkëjetojë me përkushtimin ndaj vendit.

Familjet ushtarake, themeli i forcës kombëtare

Pas çdo ushtaraku dhe ushtarakeje që ngre flamurin me krenari dhe përkushtim, qëndron një familje e tërë që mbështet, pret dhe sakrifikon në heshtje. Nënat, baballarët, bashkëshortët dhe fëmijët e tyre janë pjesë e pandashme e misionit ushtarak, duke qenë gjithmonë shtylla kryesore e mbështetjes morale dhe shpirtërore.

Familjet ushtarake janë themeli i qëndrueshmërisë së Forcave të Armatosura. Ato përballen me sfida të përditshme që shkojnë përtej kufijve personalë nga mungesat e gjata të anëtarëve të familjes, deri tek ndjenja e vazhdueshme e pasigurisë për shkak të natyrës së shërbimit ushtarak.

Megjithatë, përmes qëndrueshmërisë, durimit dhe mbështetjes së tyre, ushtarakët kanë forcën për të përmbushur me dinjitet detyrat që u ngarkohen.

“Shërbimi i ushtarakut nuk është vetëm i tij, por i të gjithë familjes”, shprehen shpesh ata. Ky dimension i pazëshëm i mbrojtjes kombëtare dëshmon se sakrifica dhe përkushtimi nuk kufizohen vetëm në radhët e ushtrisë, por përfshijnë edhe komunitetin e gjerë të familjeve të tyre.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura e njohin dhe e vlerësojnë rolin e pazëvendësueshëm të familjeve ushtarake. Investimi në mbështetjen e tyre përmes politikave sociale, psikologjike dhe komunitare është një domosdoshmëri për të garantuar jo vetëm mirëqenien e tyre, por edhe efikasitetin e

Puthja e nënës në uniformë: Sakrifica e heshtur në fillim të vitit shkollor



misionit të ushtarakëve tanë.

Nëse ushtarakët janë mbrojtësit e kufijve dhe sigurisë kombëtare, familjet e tyre janë mbrojtësit e stabilitetit dhe forcës së brendshme të shoqërisë. Bashkë, ata formojnë një aleancë të pathyeshme, ku flamuri nuk është vetëm simbol shtetëror, por një betim i përbashkët për atdheun.

Pas çdo gruaje apo burri në uniformën ushtarake që ngre flamurin kuq e zi, qëndron një nënë, një baba dhe një fëmijë që jetojnë për të njëjtën kauzë.

Puthja e nënës dhe babait në uniformë para shkollës nuk është thjesht një gjest i zakonshëm prindëror. Është një simbol i fortë i sakrificës dhe dashurisë së dyfishtë për fëmijën dhe

për atdheun.

Në fillim të çdo viti shkollor, këto puthje të heshtura na kujtojnë se mësimi i parë që marrin fëmijët e familjeve ushtarake nuk është vetëm në libra, por në jetën e përditshme: se dashuria matet edhe me sakrificë, dhe se krenaria lind nga përkushtimi.

Fëmijët e prindërve ushtarake që në këtë fillim viti shkollor hapin librat e parë, rriten si trashëgimtarë të një force të jashtëzakonshme. Ata bartin jo vetëm ëndrrat e tyre, por edhe krenarinë e madhe të të qenit pjesë e një familjeje që jeton dhe sakrifikon për Shqipërinë.

Suksese të ardhmes së ndritur të këtij vendi të vogël, por me emër të madh, Shqipëri!





NGA MAJOR (R) NEXHBEDIN BASHA

Tre Yje që Nuk Perëndojnë Kurrë

Ka momente kur fjala hesht, kur shkrimi ndalon, sepse përballë sakrificës së jetës, gjithçka tjetër merr një hap mbropa.

Në radhët e Forcave të Armatosura, janë shkruar faqe nderi me emra që nuk do të fshihen kurrë nga kujtesa. Major Klodian Tanushi, nëntetare Zarife Hasanaj dhe kapiten Feti Vogli, janë tre prej tyre, dëshmorë të lirisë, të paqes dhe të kombit, që ranë në krye të detyrës.

Major Klodian Tanushi – Nder përjetë i uniformës shqiptare



Atje ku dëshmorët kthehen në yje të gjallë
E ndriçojnë udhët e Shqipërisë së lirë,
Fjala jote gjemb që u përgjakë,
Në shpirtin tënd qelibar e dritë...

Mina e mallkuar t'mori jetën, rininë,
jo nderin, as krenarinë ngjizur në deje.
Ti mbete yll i pashuar dhe në Letoni,
heroizmi yt ndezi zemrën e çdo ushtari.

Loti i nënës pikon rëndë në zemër,
Për birin që përkundi në djep me ninullë,
Familja e pret si fllad bjeshke rrëzë Korabit,
me Drinin që ja freskon ballin e tij të argjendt'.

Gjaku yt që s'tahet është rrënjë e dheut.
Në sytë e fëmijëve ti je dritë kujtimi,
një baba hero që u flijua për paqe.
Në zemrën e gruas rron si shpirt drite,

Emri i Klodianit u shkrua në gurë, male e fusha,
mbetur në këngë e në vargje poeti,
Fjala e tij e thjeshtë do të kalojë brez pas brezi.
në kufijtë e zemrës rron si Dëshmor i Atdheut.

Nëntetare Zarife Hasanaj – Vajza që ra për Paqen



Në Camp Adazi, me guxim dhe devotshmëri, mbrojtë jetë dhe ndërtoi besim
Mëngjesi i së hënës, më 6 maj 2019, do të mbetet përjetësisht në memorien e kombit shqiptar dhe atij letonez. Në një operacion çminimi në bazën e NATO-s, Camp Adazi, në Letoni, Nëntetare Zarife Hasanaj humbi jetën në krye të detyrës. Shpërthimi tragjik ndodhi gjatë një misioni për asgjësimin e municioneve, ku Hasanaj shërbente si operatore EOD, pjesë e kontingjentit shqiptar të Kompanisë së Asgjësimit të Forcave të Armatosura. Bashkë me të u plagosën edhe Major Klodian Tanushi, i cili, nuk do t'u rezistonte plagëve dhe më 10 maj 2019, do të ndërronte jetë. Në atë operacion u plagos rëndë dhe Rreshter Julian Kapaj.

Zarife Hasanaj ka lindur më 1987, në qytetin Bajram Curri dhe jetonte në Babrru të Tiranës. Ajo ishte fëmija i katërt i familjes Hasanaj. Pas përfundimit të gjimnazit "Gramoz Palushi", në vitin 2006, ajo ndoqi studimet e larta në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në profilin "Hortikulturë". Në vitin 2008, u mobilizua në FA si ushtare profesioniste, dhe në vitin 2013 mori gradën nëntetare. Përgatitja e saj përfshinte trajnimet EOD për çminim, si dhe ndihmën e parë në incidente me eksplozivë.

Në dhjetor 2018, ajo u dërgua me mision në kuadër të operacionit të NATO-s në Letoni, në përbërje të Grup-Batalionit Kanadez, me detyrë operator EOD. Ajo ishte pjesë e një kontingjenti që punonte në kushte të vështira, por me përkushtim të plotë ndaj detyrës, për paqen dhe sigurinë. E vetmja grua dëshmore në historinë e misioneve ndërkombëtare shqiptare, humbi jetën në të njëjtin mision, në tokë të huaj, por me një ideal që s'kishte kufij.

Zarife Hasanaj – Flakë e Atdheut

Në tokën ku dridhet era e lirisë,
Ku qielli mban flakën e nderit,
Ra si heroinë bija e Shqipërisë,
Zarife Hasanaj, mbrojtëse e atdheut.

Me sy të zjarrtë dhe zemër të hekurt,
Flamurin ngrite mbi vullnetin tënd,
Pishtar ndriçues i shpresës së pafaj,

Ra në krye të detyrës, duke mbrojtur jetën, paqen dhe nderin ushtarak

Në mozaikun e emrave që i dhanë lavdi Atdheut, një nga figurat më të ndritura të Dibrës është Major Klodian Tanushi – dëshmor i Atdheut dhe simbol i gjallë i sakrificës për paqen ndërkombëtare.

Lindi më 31 tetor 1980, në qytetin e Peshkopisë, në një familje me traditë ushtarake. Babai i tij, Basriu, ishte oficer ushtrie – një shembull që Klodiani do ta ndiqte me përkushtim dhe krenari. Shkollimin fillestar e kreu në shkollën "Demir Gashi", ndërsa arsimin e mesëm në shkollën "Nazmi Rushiti", në profilin "xhenerik motorist". Në vitin 2000, falë rezultateve të larta dhe vullnetit të hekurt, u pranua në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", në degën e xhenios, dhe më 2003 u diplomua me gradën nëntoger.

Në ceremoninë e diplomimit, i ati tha me krenari: "Jam krenar që djali im ndoqi ëndrrën e tij për t'i shërbyer kombit me uniformë".

Pas diplomimit, shërbeu me devotshmëri si komandant toge, komandant kompanie, shef seksioni dhe specialist operacionesh. Në vitin 2017 u angazhua në misionin paqeruajtës "Althea" në Bosnje, ndërsa në 2019 u emërua komandant i kontingjentit shqiptar në misionin e NATO-s në Letoni.

Më 6 maj 2019, gjatë një operacioni çminimi, ndodhi fatkeqësia: humbi jetën Nëntetaria Zarife Hasanaj dhe Major Tanushi mbeti rëndë i plagosur. Më 10 maj, pavarësisht përprjekjeve të mjekëve, ai ndërroi jetë në krye të detyrës.

U shpall "Dëshmor i Atdheut" me vendim nr. 786, datë 13.05.2019, dhe u dekorua me:

- "Medaljen e Nderit" – Ministria e Mbrojtjes
- "Medaljen e Luftëtarit" – Shtabi i Përgjithshëm i FA-së
- "Dekoratën e Artë të Shqiptonjës" – Presidenti i Republikës

("Për kontribut të veçantë në mbrojtje të vlerave kombëtare, i rënë në mbështetje të paqes në botë")

U shpall "Qytetar Nderi i Qarkut Dibër", dhe vepra e tij është përjetësuar në Qesarakë (Tiranë), ku një shkollë 9 vjeçare moderne mban emrin "Klodian Tanushi". Në ambientet e saj është ngritur një bust nderimi dhe një muze me sendet personale të dëshmorit, që i flasin çdo brezi për heroizmin, përkushtimin dhe sakrificën për Atdheun.

I martuar, baba i tre fëmijëve, dy djem dhe një vajzë, ai do të mbetet përjetësisht një emër i skalitur në kujtesën kombëtare: hero që ra në krye të detyrës, për të mbrojtur jetën dhe lirinë.

Bajrak i gjallë i nderit

*(Kushtuar Dëshmorit të Atdheut,
Klodian Tanushi)*

Në fletën e verdhë, germa që flasin,
dhimbje që përtyp trishtim.
Klodian, ti re si hero, në fushën e betejës,
mbete pishtar i pashuar në flamur.

O Klodian Tanushi, gjaku i Skënderbeut,
Dibra të lindi, Shqipëria të rriti,
Me shpirt ushtari, me zemër prej dielli,
Në gjoksin tënd flamuri dritë nderi për jetë,

Ti nuk re për vete, por për Atdhe,
për familjen, për fëmijët, për kombin mbarë.
Emri yt është betim, amanet i shenjtë:
"Të duam Shqipërinë, deri jetën kemi falë."



Në fshatin Baldushk të Tiranës, më 23 mars 1981, lindi Feti Vogli, djali që do të rritej për të ndjekur rrugën e nderit ushtarak. Mbaroi Akademinë Ushtarake në specialitetin Artileri Tokësore dhe nisi karrierën si komandant toge në Brigadën e Stërvitjes Bazë në Bunavi. Me kalimin në Forcat Speciale, pas kursit bazë, më 2005, ai u bë komandant grupi, e më vonë drejtues i Grupit të Parë Special në Kompaninë e Aksioneve Speciale Ujore.

Kapiten Vogli u dallua për përkushtim, guxim dhe profesionalizëm. U dekorua me Medaljen e Karrierës, Medaljen për Shërbime Ndërkombëtare, dhe Medaljen për Shërbime të Shquara, duke qenë ndër ushtarakët më të vlerësuar të brezit të tij.

Më 16 janar 2012, u nis drejt Kandaharit, në kuadër të misionit luftarak “Eagle 4”. Më pak se dy muaj më pas, më 20 shkurt, ra dëshmor në krye të detyrës, gjatë një operacioni të forcave speciale. Ra me armën në dorë dhe Shqipërinë në zemër.

Në atë kohë shërbeja si misionar i paqes, shef personeli dhe psikolog kontingjenti në bazën shumëkombëshe, Herat, Afganistan. Dhimbja që përjetuam ishte e rëndë. Në një akt të rrallë nderimi, të gjithë flamujt e NATO-s dhe vendeve partnere u ulën në gjysmështizë – mes tyre edhe flamuri kombëtar shqiptar, që valëvitej i pikëlluar për birin e vet të rënë, për paqe e liri.

Në qendër të Garnizonit të Zall-Herrit, qëndron sot busti i tij, për të kujtuar një oficer që nuk e uli kurrë kokën dhe se mbeti hero i paqes dhe nderi i kombit.

Edhe pse nuk isha në Kandahar, pasi kryeja detyrën në Herat, dhimbjen e përjetova njëlloj si gjithë populli dhe ushtria shqiptare. Ajo ditë ishte e rëndë — se na iku një prind, një shok, një mik, një oficer karriere, për të cilin kishte nevojë Atdheu. Ai nuk ra vetëm në një betejë të largët, por u ngjit në përjetësi si simbol i lirisë dhe përkushtimit.

Në 6-vjetorin e rënies në krye të detyrës, kujtimi i dëshmorit të atdheut, kapiten Feti Vogli, u nderua edhe në tokën ku ai dha jetën – në Afganistan.

Fotografia dhe vepra e tij sublime u vendosën në Hollin e Trimërisë (Muri i të Rënëve) në Kabul, krah për krah me ushtarakët e NATO-s që ranë në krye të detyrës në këtë vend të trazuar.



Kapiten Feti Vogli – Dëshmori që ra me armën në dorë dhe Shqipërinë në zemër



Amaneti yt, s’tretet o lule zambak...!
Kushtuar Dëshmorit të Atdheut Kapiten Feti Vogli

Ç’është një za që vjen përtej detit,
Nga një pëllumb në fluturim?
Si trim ra kapiten Vogli,
Si lule në lulëzim.

Ra në fushën e betejës si trimat,
Paqe solli në atë copë atdhe;
Edhe malet e Shqipërisë ulën kokën,
Lajmi kobshëm mbuloi dhenë.

S’fëshfërijnë as gjethet e pemëve,
Retë e bardha u bënë të murrme,
Dhimbja pllakosi Shqipërinë ku linde,
Si hero në betejë, kokën kurrë s’e ule.

Nëna pret djalin te pragu i shtëpisë,
E puth ballin që ndrin si ar,
Ta ledhatoj, ta pyes për amanetin,
Të çmallet me fëmijë, babai gojëmjaltë.

Fetiu ra, siç bien Heronjtë e Kombit,
Në Afganistan, ku dielli s’ngroh as kolibet;
Liri dhe paqe mbolli në gjithë botën,
Dritë e jetë dhuroi për njerëzinë.

Në shkurt 2012, në Herat u gjenda
Si misionar paqe me kontingjentin shqiptar;
Harabelat heshtën, flamujt e bazës u ulën gjysmështizë,
Përjetuam një dhimbje të pa masë.

Si misionar i paqes, krah NATO-s,
Fetiu luftoi, paqe solli në atë vend mynxyrë;
Ktheu buzëqeshjen çdo fëmije në botë,
“Dëshmori i Atdheut”, pishtar drite lirie.

O Feti Vogli, biri i Shqipërisë,
Si oficer karriere ke mbetur një lot meraku;
Kënga kushtuar ty është himn për ushtrinë:
Amaneti yt s’tretet, o lule zambaku!

Reflektim personal për tre dëshmorët

Edhe pse në ato çaste nuk ndodhesha fizikisht në Letoni apo Kandahar, ndjeva të njëjtën dhimbje që përjetoj çdo pjesëtar i Forcave të Armatosura dhe gjithë kombi. Na ikën tre njerëz të shtrenjtë, kapiten Feti Vogli, major Klodian Tanushi dhe nëntetarja Zarife Hasanaj. Tre emra që nuk janë thjesht pjesë e një liste dëshmorësh, por gur themeli të një kujtese kolektive, që do të jetojë përherë në zemrat tona.

Na iku një prind, një mik, një shok, një vajzë e re, një oficer karriere, një ushtarak me përkushtim të rrallë, që i dhanë shumë më tepër Atdheut sesa morën. Na iku zëri i jetës dhe i paqes, që nuk do të heshtë kurrë në ndërgjegjen tonë kombëtare.

Emrat e tyre, “Dëshmorët e Atdheut”, nuk jetojnë vetëm në pllaka përkujtimore apo dokumente shtetërore. Ata janë gdhendur në ndërgjegjen tonë kombëtare. Janë atje, çdo herë që ngrihet flamuri, çdo herë që një ushtarak shqiptar niset për një mision të ri. Këta nuk janë vetëm heronj me uniformë. Janë ylltaria e gjallë e Shqipërisë, që ndriçon përtej territoreve, në emër të paqes, lirisë dhe nderit. Në shpirtin tim, ata mbeten figura frymëzuese, simbole të një ideali të pastër, të një misioni të përbashkët për jetën, nderin dhe paqen. Ata ranë në krye të detyrës duke mbrojtur jetën, paqen dhe nderin ushtarak shqiptar.

Uniforma, pasqyra e disiplinës dhe përkatësisë

Uniforma ushtarake është elementi i parë që bie në sy te çdo efektiv i Forcave të Armatosura. Ajo nuk është vetëm një veshje pune, por një simbol i disiplinës, përkushtimit dhe respektit ndaj misionit. Uniforma shqiptare ka kaluar disa faza zhvillimi gjatë viteve, duke u përshtatur me kohën, misionet dhe standardet e NATO-s, ku vendi ynë bën pjesë.

Uniforma përbën edhe një element të rëndësishëm identifikimi për qytetarët: kur shohin ushtarin e veshur me uniformë, ata shohin përfaqësuesin e shtetit, të sigurisë dhe të rendit. Për efektivet, mbajtja e saj është një nder dhe përgjegjësi, sepse çdo ditë përfaqësojnë Ushtrinë Shqiptare në publik.

Simbolet që bartin histori dhe traditë

Në çdo pjesë të uniformës vendosen simbolet që tregojnë përkatësinë dhe traditën. Stema e Forcave të Armatosura, shqiponja dykrenare, ngjyrat e flamurit dhe elementë të tjerë të identitetit kombëtar janë pjesë e pandashme e uniformës.

Simbolet e mbajtura mbi uniformë lidhen ngushtë me historinë e ushtrisë sonë, duke nisur nga periudha e Luftës Nacionalçlirimtare, e deri tek Ushtria moderne e shekullit XXI. Ato janë një urë lidhëse mes brezave të ushtarakëve, duke kujtuar gjithmonë sakrificat dhe kontributin e atyre që shërbyen më parë.

Shenjat dalluese, hierarkia dhe profesioni në shërbim

Një element i veçantë në uniformë janë shenjat dalluese, të cilat përcaktojnë gradën, funksionin dhe repartin e çdo ushtari. Nga njëri efektiv te tjetri, shenjat tregojnë hierarkinë, duke siguruar rend, disiplinë dhe respekt për strukturën komanduese.

Shenjat dalluese nuk janë vetëm simbole hierarkike, por edhe profesionale. Për shembull, efektivet që i përkasin forcave tokësore, ajrore apo detare mbajnë simbole të ndryshme dalluese. Po ashtu, uniforma e mjekëve ushtarakë, e trupave speciale apo e policisë ushtarake ka shenja unike që e identifikojnë qartë rolin e tyre.

Armatimi, garanci për mbrojtjen dhe sigurinë

Ashtu si uniforma dhe simbolet, edhe armatimi është një pjesë e pandashme e portretit të ushtrisë. Forcat e Armatosura



Uniforma, simbolet dhe armatimi, identiteti i Forcave të Armatosura

shqiptare janë të pajisura me armë dhe mjete që i përgjigjen nevojave moderne, duke siguruar aftësi të plota për mbrojtjen e vendit dhe për misionet ndërkombëtare.

Armatimi përbën një element sigurie dhe përgjegjësie. Çdo efektiv trajnohet për ta përdorur me profesionalizëm, duke respektuar rregullat e sigurisë dhe misionin e tyre. Nga pajisjet individuale të lehta deri tek mjetet e rënda dhe teknologjitë e avancuara, armatimi është garancia që ushtria të jetë gjithmonë gati.

Identiteti i përbashkët i Forcave të Armatosura

Uniforma, simbolet, shenjat dalluese dhe armatimi, të marra së bashku, përfaqësojnë identitetin e plotë të Forcave të Armatosura. Ato janë elementët që bëjnë dallimin mes një individi të thjeshtë dhe një ushtari në shërbim të kombit. Për ushtarin shqiptar, këto nuk janë vetëm mjete pune apo shenja formale. Ato përfaqësojnë nderin e të shërbyerit nën flamurin kuqezi, disiplinën e përditshme dhe përkushtimin ndaj sigurisë së qytetarëve dhe sovranitetit të vendit.



Shenja krahëse kombëtare



Shtabi i Përgjithshëm



Forca Tokësore



Forca Ajrore



Forca Detare



Akademia e FA



Komanda Mbështetëse



Batalioni i Forcave Speciale



Batalioni Komando



Policia Ushtarake

Shkolla: Themel i Dijes dhe Kombit



ШКОЛА Е ВАГАВЕТ ГОРП НЕ КОРЧЕ.

Më 24 maj 1891, u themelua instituti i parë femëror në Shqipëri, “Kyrias”, falë nismës së "flamurtarës së lirisë", Sevasti Qiriazit, e cila së bashku me të motrën, Parashqevinë, edukuan disa breza të rehash.



Më 1 maj 1889, gjuhëtari, historiani dhe arsimtari i përkushtuar, Mati Logoreci, ndërmori nismën për hapjen e shkollës së parë shqipe në Prizren.

Shkollat e para shqiptare - Fillimi i rrugëtimit të dijes

Kur flasim për Shqipërinë e shekullit të 19-të, nuk mund të harrojmë vendin ku çdo gjë filloi, shkollën. Në kohën kur shumica e popullsisë nuk kishte mundësi të mësonte gjuhën e vet, shkollat e para shqiptare u shndërruan në qendra të dijes, kulturës dhe identitetit kombëtar.


Institucionet e para në Shkodër dhe Korçë nuk mësuan thjesht lexim e shkrim. Ato rritën breza të rinj me vetëdije kombëtare, u hapën dyer për gjuhën shqipe dhe forcuan lidhjen e shqiptarëve me historinë e tyre. Ishte një sfidë e madhe, pasi për shumë vite arsimi në gjuhën amtare ishte i ndaluar. Por dëshira për dije dhe liri kulturore ishte më e fortë se çdo pengesë.

Rëndësia e këtyre shkollave shkon përtej mësimi. Ato vendosën themelet për një shoqëri të arsimuar, për qytetarë të vetëdijshëm dhe për zhvillimin e Shqipërisë. Sot, çdo shqiptar i edukuar i detyrohet atyre institucioneve të vogla që ndezën zjarrin e dijes dhe të identitetit kombëtar.

Për ushtrinë dhe çdo institucion të vendit, arsimi mbetet armë e fuqishme. Ai krijon qytetarë të përgjegjshëm, të ditur dhe të gatshëm për sfidat e sotme dhe të nesërme. Shkollat e para shqiptare nuk janë thjesht histori, janë inspirim dhe kujtesë se çdo shoqëri e fortë nis me dijen e rinisë së saj.

Shkolla dhe Arsimi: Çelësi i së Ardhmes

Shkolla nuk është thjesht një ndërtesë me klasa, ajo është vendi ku fillon çdo ëndërr, ku formohet karakteri dhe ku lind vetëdija kombëtare. Arsimi na mëson të lexojmë botën,



Në vitin 1887, veprimtari Petro Nini Luarasi hapi në Ersekë shkollën e parë shqipe dhe përgjatë viteve 1892-1893, shkollat shqipe në krahinën e Kolonjës dhe të Vakëfeve.

të kuptojmë sfidat dhe të ndërtojmë një të ardhme më të fortë dhe më të drejtë.

Për çdo shqiptar, çdo dije e marrë në shkollë është një hap drejt lirisë, suksesit dhe përgjegjësisë ndaj shoqërisë. Arsimi nuk është luks, ai është detyrë, mjet dhe armë për të përballuar çdo sfidë.

Kujdesu për dijen, respekto shkollën dhe investo në veten tënde. Çdo libër që hap, çdo leksion që mëson, është një hap drejt një Shqipërie më të ditur dhe më të fortë.





Kjo foto, që daton më 1916-n, na shpie në anën tjetër të Drinit, në vatrën e parë të dijes në Gjakovë, në shkollën "Skëndërbej".

Shkolla dhe Ushtria: Një bashkëpunim për Forcën e Mendjes dhe të Karakterit

Shkolla nuk është thjesht vendi ku mësojmë lexim e shkrim, ajo është vendi ku formohet mendja dhe karakteri i çdo individi. Një ushtar i arsimuar kupton më mirë urdhrat, merr vendime të shpejta dhe të sakta në situata kritike, dhe mësohet të punojë në grup me përgjegjësi.

Për ushtrinë, arsimi është një “armë” e fuqishme. Çdo njohuri që merr një individ në shkollë bëhet pjesë e disiplinës, profesionalizmit dhe gatishmërisë për të përballuar sfidat. Shkolla dhe ushtria nuk janë botë të ndara; ato bashkohen në një mision të përbashkët: të forcojnë mendjen, karakterin dhe shoqërinë.

Një komb i fortë nuk krijohet vetëm me armë, por me dijen që ushtari dhe qytetari e mbart çdo ditë. Shkolla është themeli, ushtria është mburoja, dhe së bashku formojnë një Shqipëri të fortë dhe të përgatitur për çdo sfidë.

Shqipëria midis pushtuesve: Italia, Gjermania dhe Rruga drejt Çlirimit

Më 8 shtator 1943, situata politike ndryshoi për Shqipërinë. Italia, pushtuesi që kishte sunduar vendin për më shumë se një dekadë, kapitulloi para forcave aleate. Ky akt i papritur krijoi një boshllëk të madh politik dhe ushtarak në vend, i cili nuk vonoi të zëvendësohej nga ushtria gjermane.

Ndryshe nga italianët, që kishin synime të qarta aneksimi dhe kontrolli, gjermanët nuk kishin interesa afatgjata në Shqipëri. Strategjia e tyre ishte pragmatike, mbajtja e kontrollit për të përmbushur qëllimet e Luftës së Dytë Botërore, por pa krijuar një strukturë koloniale të përhershme.

Mbretinija Shqiptare dhe pushtimi Gjerman

Gjatë këtij pushtimi, rendi qeverisës de jure i Shqipërisë mbeti “Mbretinija Shqiptare”. Ky fakt tregonte për një sovranitet relativ që u lejua nga Gjermania, e cila nuk kishte problem me një Shqipëri që pretendonte të ishte e madhe dhe e pavarur brenda kufijve të saj etnikë. Pavarësisht kësaj, Gjermania imponoi rregulla të ashpra, shpalli gjendjen e luftës, kërkoi dorëzimin e armëve dhe kërcënoi se çdo sulm ndaj trupave gjermane do të pasohej nga vrasja e dhjetë shqiptarëve për çdo gjerman të vrarë.

Në këto kushte, qytetarët shqiptarë përballeshin me një realitet të rreptë. Jeta e përditshme ishte e mbushur me frikë dhe pasiguri, ndërsa ushtria gjermane ndërmerre ekspedita ndëshkimore që shpesh shoqëroheshin me mizori ndaj civilëve. Të gjitha këto shënuan një nga periudhat më të vështira në historinë e vendit, duke krijuar një klimë terrori dhe tensioni që preku çdo familje shqiptare.

Balli Kombëtar dhe politika e pushtimit

Në këtë skenë, Balli Kombëtar u favorizua mbi legalistët e Mbretit Zog. Për gjermanët, ky grupim nacionalist ishte partneri më i besueshëm për të ruajtur stabilitetin dhe për të administruar territorin pa ndërhyrje direkte gjermane. Balli Kombëtar mori përgjegjësinë mbi Shqipërinë dhe territoret e saj të zgjeruara, duke përfshirë pjesën më të madhe të Kosovës, Maqedoninë Perëndimore, dhe një rrip të Malit të Zi.

Politika e Ballit Kombëtar synonte të bashkonte të gjitha trojet shqiptare nën një shtet të vetëm, një aspiratë që ndikoi fuqishëm në marrëdhëniet me Gjermaninë dhe aktorët e tjerë politikë brenda vendit.

Një “qeveri neutrale” u formua mes gjermanëve dhe Ballit Kombëtar në Tiranë, duke krijuar një situatë të ndërlikuar, ku shqiptarët gjetën veten nën një lloj administrate të përbashkët pushtues-shqiptar. Megjithatë, politika gjermane ishte e ashpër ndaj çdo kundërshtimi. Çdokush që kapte armë ose materiale ushtarake rrezikonte pushkatimin. Kjo politikë e ashpër krijoi tensione të mëdha mes civilëve dhe forcave pushtuese, duke nxitur ndjenja të forta rezistence dhe rebelimi.

Partia e Legalitetit dhe skena politike shqiptare

Në këtë periudhë të trazuar, u shfaq dhe Partia e Legalitetit, e përbërë nga mbështetësit e Mbretit Zog. Ky grupim përfaqësonte një alternativë politike ndaj Ballit Kombëtar dhe kërkonte rivendosjen e monarkisë si bazë të qeverisjes.

Marrëdhëniet mes grupeve shqiptare ishin shpesh armiqësore, duke reflektuar tiparet e një lufte civile paralel me rezistencën kundër pushtuesve. Ndërsa Balli Kombëtar synonte bashkimin e trojeve shqiptare nën një shtet, Partia e Legalitetit luftonte për rivendosjen e rendit monarkik, duke u bërë një faktor tjetër kompleks në politikën e vendit.

Rezistenca dhe lufta për çlirim

Pavarësisht politikave dhe marrëveshjeve të imponuara



ME KRIJIMIN E ALEANCËS SË MADHE DHE PËRKEQËSIMIN E SITUATËS PËR GJERMANINË NË FRONTIN E LUFTËS, REZISTENCA SHQIPTARE U INTENSIFIKUA. LUFTA VAZHDOI ME SAKRIFICA TË MËDHA, DUKE MOBILIZUAR TË RINJTË DHE CIVILËT QË DËSHIRONIN LIRI. SHUMË QYTETE DHE FSHATRA U BËNË SKENA TË PËRBALLJEVE TË DHUNSHME, NDËRSA SHQIPTARËT U ANGAZHUAN ME KURAJË PËR TË ÇLIRUAR VENDIN E TYRE.

nga Gjermania, shqiptarët nuk qëndruan pasivë. Partizanët komunistë filluan të zhvillonin sulme të fuqishme ndaj forcave gjermane dhe Ballit Kombëtar. Me krijimin e Aleancës së Madhe dhe përkeqësimin e situatës për Gjermaninë në frontin e luftës, rezistenca shqiptare u intensifikua. Lufta vazhdoi me sakrifica të mëdha, duke mobilizuar të rinjtë dhe civilët që dëshironin liri. Shumë qytete dhe fshatra u bënë skena të përballjeve të dhunshme, ndërsa shqiptarët u angazhuan me kurajë për të çliruar vendin e tyre.

Çlirimi i vendit arriti kulmin, më 28-29 nëntor 1944, kur Shqipëria u shpall e lirë nga pushtuesit. Ky moment historik përfaqësoi fundin e një kapitulli të vështirë, por edhe triumfin e vendosmërisë së shqiptarëve për të ruajtur sovranitetin dhe pavarësinë e vendit.

Mësime nga historia

Kapitulli i pushtimit gjerman dhe periudhës së Ballit Kombëtar tregoi për kompleksitetin e politikës shqiptare në kohë lufte. Ai thekson rëndësinë e unitetit kombëtar, rolin e fuqishëm të rezistencës dhe ndikimin e faktorëve të jashtëm në zhvillimet politike të vendit.

Ndërsa Gjermania synonte të ruante kontrollin përkohësisht, shqiptarët arritën të ruajnë aspiratën për sovranitet dhe pavarësi.

Historia e kësaj periudhe mbetet një kujtesë për guximin, sakrificën dhe përpjekjen për një Shqipëri të lirë.

Ky kapitull i historisë është gjithashtu një mesazh për brezat e sotëm, liria dhe pavarësia nuk fitohen vetëm me armë, por edhe me unitet, ndërgjegje kombëtare dhe kurajë për të mbrojtur të drejtën për të vendosur fatin e vendit.



11 Shtatori 2001 – Dita që ndryshoi botën
Mëngjesi i 11 shtatorit 2001 do të mbahet mend si një nga ditët më të zeza të historisë moderne. 19 terroristë islamikë të rrjetit ekstremist Al Qaeda morën peng katër avionë pasagjerësh dhe i përdorën si armë kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Sulmet e koordinuara

- 08:45 – Një avion i parë goditi Kullën Veriore të World Trade Center në Nju-Jork.
- 09:03 – Një avion i dytë u përplas me Kullën Jugore, duke zbuluar qartë se bëhej fjalë për një sulm të organizuar terrorist.
- 09:45 – Një avion tjetër u përplas në Pentagon, godina e selisë së Departamentit të Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara.
- 10:03 – Avioni i katërt u rrëzua në Shenksvil, Pensilvani, pasi pasagjerët u përpoqën t’i ndalonin terroristët.
- 10:30 – Brenda pak minutash, të dy kullat binjake u shembën, duke lënë pas mijëra viktima dhe rrënoja të pamasë.

Bilanci tragjik

- 2977 njerëz humbën jetën, pa përfshirë 19 terroristët.
- Mes tyre, 246 pasagjerë dhe ekuipazhe në avionë, 2606 persona në Nju-Jork dhe 125 viktima në Pentagon.
- Viktima më e re ishte Christine Lee Hanson, vetëm 2 vjeç, ndërsa më i moshuari Robert Norton, 82 vjeç.
- Të vrarët vinin nga 78 vende të ndryshme, duke e kthyer sulmin në një tragjedi globale.
- Qyteti i Nju-Jorkut humbi 441 punonjës të ndërhyrjes së shpejtë, kryesisht zjarrfikës dhe policë.

Autorët e sulmit

Sulmet u planifikuan nga Al Qaeda, e udhëhequr nga Osama Bin Laden, i cili e konsideronte SHBA-në armikun kryesor të botës islame.

Nga 19 pengmarrësit:

- 15 ishin sauditë,
- 2 nga Emiratet e Bashkuara Arabe,
- 1 nga Egjipti,
- 1 nga Libani.

Të gjithë kishin marrë trajnim në shkolla amerikane të aviacionit.

Reagimi amerikan

Vetëm pak javë më vonë, presidenti George W. Bush shpalli luftën kundër terrorizmit dhe udhëhoqi pushtimin e Afganistanit. Qëllimi ishte shkatërrimi i Al Qaeda-s dhe kapja e Bin Ladenit, i cili u vra në Pakistan në vitin 2011. Arkitekti i sulmeve, Khalid Sheikh Mohammad, u arrestua në 2003 dhe mbahet ende në Guantanamo.

Nga Nju-Jorku në Pentagon: Kujtesa e një tragjedie globale

Trashëgimia e 11 Shtatorit

Pas ngjarjeve, siguria ajrore u forcua ndjeshëm, duke u krijuar Administrata e Sigurisë në Transport (TSA). Në zonën e rrënojave, të quajtur Ground Zero, u ndërtua një memorial për viktimat dhe në vitin 2014 u inaugurua One World Trade Center, i njohur

si Kulla e Lirisë, më e larta në hemisferën perëndimore. Pentagonit iu desh më pak se një vit për t’u rindërtuar. 11 Shtatori mbetet një plagë e pashlyeshme dhe një kujtesë e përhershme e kërcënimit terrorist, por edhe e forcës dhe qëndresës njerëzore.





Në peizazhin në ndryshim të gjeopolitikës evropiane, një pretendent i ri po shfaqet në heshtje por fuqishëm: Polonia. Dikur e lënë në hije nga fuqitë tradicionale të rënda - Gjermania, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar - Polonia tani po e afirmon veten si një forcë e fuqishme në çështjet rajonale dhe globale. Ky transformim nuk është vetëm ekonomik apo ushtarak; është thellësisht i rrënjosur në qëndrueshmërinë historike, pozicionimin strategjik dhe një identitet kombëtar të ripërtërirë.

Nga hijet sovjetike në forcën sovrane

Udhëtimi i Polonisë nga një shtet satelit sovjetik në një demokraci të lulëzuar ka qenë thjesht dramatik. Që nga fitimi i pavarësisë pas rënies së Bashkimit Sovjetik, vendi ka kaluar nëpër reforma të thella, ka modernizuar infrastrukturën e tij dhe ka kultivuar një ekonomi të fortë. Plagët e së kaluarës kanë nxitur një vendosmëri të fortë për të mos qenë më kurrë i prekshëm nga dominimi i jashtëm.

Ky kontekst historik është thelbësor. Ai shpjegon qëndrimin proaktiv të Polonisë në mbrojtjen evropiane, mbështetjen e saj të zëshme për NATO-n dhe investimet e saj në rritje në aftësitë ushtarake. Udhëheqja e vendit e kupton se sovraniteti duhet të mbështetet nga forca.

Ambiciet ushtarake dhe ndikimi strategjik

Polonia po bëhet me shpejtësi një nga vendet më të militarizuara të Evropës. Ajo është zotuar për shpenzime të konsiderueshme në mbrojtje, duke blerë armë të përparuara dhe duke zgjeruar forcat e saj të armatosura. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me sigurinë kombëtare - ka të bëjë me leadershipin rajonal. Polonia po e pozicionon veten si një mburojë kundër agresionit rus dhe një partner të besueshëm në aleancat transatlantike. Vendndodhja e saj gjeografike - në kufi me Ukrainën, Bjellorusinë dhe shtetet baltike - e bën atë një pikë kyçe strategjike në krahun lindor të NATO-s. Vendosmëria e Varshavës në mbështetjen e Ukrainës dhe sfidimin e ndikimit rus i ka fituar asaj respekt dhe vëmendje në të gjithë kontinentin.

Një bosht i ri ndikimi

Ngritja e Polonisë përkon me ndryshime më të gjera globale. Ndërsa tensionet përshkallëzohen midis Perëndimit dhe fuqive si Kina dhe Rusia, po formohen aleanca të reja. Organizata e Bashkëpunimit të Shangait (SCO), e udhëhequr nga Kina dhe duke përfshirë Rusinë, Indinë dhe Iranin, po kundërshton atë që e quan “ngacmim hegjemonik” nga Shtetet e Bashkuara. Presidenti Xi Jinping ka bërë thirrje për krijimin e një banke zhvillimi të SCO-së për të forcuar pavarësinë financiare dhe sigurinë kolektive midis shteteve anëtare.

Kjo dinamikë Lindje-Perëndim po riformëson diplomacinë globale. Polonia, e ankoruar fort në bllokun perëndimor, po bëhet një lojtar kyç në kundërshtimin e ndikimit autoritar dhe promovimin e vlerave demokratike.

Roli i Polonisë në të ardhmen e Evropës

Ngjitja e Polonisë nuk është pa sfida. Ajo duhet të përballojë tensionet e brendshme politike, presionet rregullatore të BE-së dhe kompleksitetet e balancimit të nacionalizmit me integrimin evropian. Megjithatë, trajektorja e saj është e qartë: Polonia nuk është më një lojtare periferike. Ajo po bëhet një arkitekthe qendrore e së ardhmes së Evropës.

Qoftë përmes forcës ushtarake, vendosmërisë diplomatike apo qëndrueshmërisë ekonomike, Polonia po ripërcakton se çfarë do të thotë të jesh një fuqi evropiane. Dhe duke vepruar kështu, ajo po riformëson ekuilibrin e ndikimit të kontinentit - një hap të guximshëm në të njëjtën kohë.

Polonia dhe NATO: Shtylla Lindore e Sigurisë Transatlantike

Ndërsa Evropa përballlet me tensione gjeopolitike në rritje dhe rigjallërimin e kërcënimeve autoritare, Polonia është shfaqur si një gur themeli i strategjisë së mbrojtjes lindore të NATO-s. Jo më vetëm një pjesëmarrëse, Polonia tani është një arkitekthe

Polonia: Rritja e një Superfuqie Evropiane



proaktive e së ardhmes së aleancës - ushtarakisht, diplomatikisht dhe ideologjikisht.

Gjeografia strategjike, përgjegjësia strategjike

Vendndodhja e Polonisë është më shumë sesa simbolike - është strategjike. E vendosur midis Gjermanisë dhe Ukrainës, dhe në kufi me Bjellorusinë dhe shtetet baltike, Polonia ndodhet në kryqëzimin e kufirit më të prekshëm të NATO-s. Kjo afërsi me Rusinë dhe luftën në Ukrainë e ka ngritur rolin e Polonisë nga aktor rajonal në mbrojtëse të vijës së parë.

Varshava është përgjigjur me urgjencë, duke pritur mijëra trupa të NATO-s dhe personel ushtarak amerikan, duke ndërtuar baza të reja ushtarake dhe qendra logjistike dhe duke mbështetur aftësitë e vendosjes së shpejtë për forcat aleate.

Infrastruktura dhe gatishmëria e Polonisë e bëjnë atë një platformë nisjeje për operacionet e NATO-s në Evropën Lindore.

Shpenzimet e Mbrojtjes dhe Modernizimi Ushtarak

Polonia është një nga vendet e pakta të NATO-s që vazhdimisht tejkalon standardin e shpenzimeve të mbrojtjes prej 2% të PBB-së të aleancës. Në fakt, ajo është zotuar të arrijë 4% të PBB-së, duke e bërë atë një nga shpenzuesit më të lartë në bllok.

Investimet kryesore përfshijnë: Blerjen e avionëve luftarakë F-35, tankeve “Abrams” dhe sistemeve raketore “Patriot”; Zgjerimin e forcave të saj të armatosura në mbi 300,000 personel; Zhvillimin e një industrie mbrojtëse vendase për të zvogëluar varësinë nga furnizuesit e huaj. Ky ndërtim ushtarak nuk ka të bëjë vetëm me frenimin - ka të bëjë me leadershipin. Polonia po sinjalizon se është gati të marrë përsipër më shumë përgjegjësi brenda NATO-s.

Vullneti Politik dhe Kohezioni i Aleancës

Polonia ka qenë një avokate e zëshme për unitetin e NATO-s, veçanërisht përballë agresionit rus. Ajo ka mbështetur Ukrainën, si ushtarakisht ashtu edhe diplomatikisht; ka bërë thirrje për prani më të fortë të NATO-s në Baltik dhe Evropën Lindore; kundër strategjive të qetësimit dhe nxori politika të forta parandaluese. Udhëheqësit polakë shpesh theksojnë se NATO duhet të mbetet e vendosur dhe e shkathët, duke u përshtatur me kërcënimet e reja pa kompromentuar vlerat e saj thelbësore.

Vizioni i Polonisë për të ardhmen e NATO-s

Polonia parashikon një NATO që është e vendosur përpara me trupa dhe pajisje më afër pikave të mundshme të nxehta; e qëndrueshme ndaj kibernetikës; e aftë të mbrohet kundër luftës hibride dhe kërcënimeve dixhitale; e unifikuar politikisht: duke i rezistuar përçarjeve të brendshme dhe duke mbajtur një qëndrim të qartë kundër regjimeve autoritare.

Në shumë mënyra, Polonia po ndihmon në ripërcaktimin e misionit të NATO-s - nga një relike e Luftës së Ftohtë në një aleancë sigurie të shekullit të 21-të që mbron demokracinë, jo vetëm kufijtë. Ngritja e Polonisë brenda NATO-s është një histori transformimi: nga një ish-satelit sovjetik në një shtyllë të mbrojtjes perëndimore. Ndërsa kërcënimet evoluojnë, evoluon edhe roli i Polonisë - duke vërtetuar se gjeografia, historia dhe bindja mund të kombinohen për të krijuar një superfuqi më vete.



Teknologjia – Aleati Strategjik i Ushtrisë Moderne

Në epokën e ndryshimeve të shpejta, teknologjia ka ndërruar rrënjësisht mënyrën se si forcat e armatosura planifikojnë, trajnojnë dhe veprojnë në fushëbetejë. Ajo nuk është më vetëm një mjet mbështetës, por një shtyllë kyçe që përcakton kapacitetin operativ, sigurinë kombëtare dhe aftësinë për të përballuar sfidat e shekullit XXI.

Transformimi Dixhital dhe Inteligjenca Artificiale

Sistemet moderne të komandimit dhe kontrollit (C2) po integrohen me rrjete komunikimi të krijuara, që lejojnë shkëmbimin e informacionit në kohë reale mes njërive në terren dhe qendrave operative. Ky bashkëveprim dixhital redukton ndjeshëm kohën e reagimit dhe minimizon mundësinë e gabimeve taktike.

Inteligjenca artificiale analizon volumet e mëdha të të dhënave për të identifikuar shenjat e kërcënimeve, sjelljet e pazakonta të armikut dhe për të parashikuar lëvizjet e ardhshme. Aplikimi i algoritmeve të mësimi të makinerive në mbrojtjen kibernetike fuqizon kapacitetin për të zbuluar dhe neutralizuar sulme në infrastrukturat kritike.

Programe trajnimi me realitet të zmadhuar dhe simulime 3D krijojnë skenarë virtualë tepër real, ku oficerët dhe ushtarët ushtrohen nën kushte të ndryshme operacionale pa shpenzuar burime të mëdha ose rrezikuar personelin në terren. Në të njëjtën kohë, platforma të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit përdorin analizë prediktive për të optimizuar logjistikën e materialeve dhe ripërtëritjen e stokeve.

Dronët, Robotika dhe Hapësira

Pajisjet ajrore pa pilot kanë ndryshuar thellësisht marrjen e informacionit të terrenit; dronët e vëzhgimit ofrojnë pamje me rezolucion të lartë, ndërsa versionet sulmuese mund të ndërhyjnë me goditje të sakta. Në paralel, robotët tokësorë po përdoren për zbulimin e minave, çminimin dhe transportin e ngarkesave të rënda, duke ulur ndjeshëm rrezikun për personelin tradicional.

Investimi në teknologjitë hapësinore është bërë pjesë thelbësore e strategjive kombëtare. Satelitët në orbitë ofrojnë kapacitete për komunikim global, navigacion preciz dhe vëzhgim të vazhdueshëm. Bashkëpunimet me aleatët në projekte satelitore përmirësojnë koordinimin ndërkombëtar dhe theksojnë rëndësinë e dominimit të hapësirës si një front strategjik.

Specifika Teknologjike


Dronët ndahen kryesisht në dy kategori. Dronët e vëzhgimit (p.sh. RQ-11 Raven, ScanEagle) ofrojnë autonomi fluturimi 6–12 orë, rreze komandimi 50–100 km dhe sisteme optoelektronike me rezolucion 4K dhe sensorë infrakuq. Dronët e armatosur (p.sh. Bayraktar TB2) mbajnë ngarkesa luftarake deri në 55 kg, fluturojnë deri në 24 orë dhe operojnë në rreze deri në 150 km, duke munduruar goditje me precizion të lartë.

Robotët tokësorë si “Talon” EOD përdoren për zbulim dhe çminim, me ngarkesë deri në 20 kg, manipulues me shumë bosht dhe autonomi deri në 4 orë. Për misione logjistike, robotët e kalimit të pengesave mbajnë deri në 100 kg, lëvizin me shpejtësi 6–8 km/h dhe mund të operojnë në mënyrë të pavarur në terrene të ndryshme.

Sistemet e komandimit dhe kontrollit (C2) karakterizohen nga vonesa komunikimi nën 40 ms për ndërveprim në kohë reale, bandë të gjerë transmetimi 100–200 Mbps për dërgim të imazheve dhe të dhënave sensorike, kriptim AES-256 për mbrojtje kundër ndërhyrjeve dhe standarde ndërveprueshmërie sipas NATO STANAG 4586 dhe 4162. Arkitektura modulare dhe rrjetet mesh garantojnë funksionim të pandërprerë edhe në rastet e ndërprerjeve të pjesshme.

Integrimi i këtyre risive lidhet ngushtë me procesin e modernizimit që ka nisur Ushtria Shqiptare, në përputhje me standardet e NATO-s dhe sfidat rajonale. Partneritetet bilaterale, pjesëmarrja në misione paqeruajtëse dhe investimet në edukimin teknologjik të personelit synojnë krijimin e një force fleksibël, të shpejtë dhe të adaptueshme.

Megjithatë, përparimi kërkon kapacitete financiare të qëndrueshme, rekrutimin dhe ruajtjen e ekspertëve të IT-së, si dhe sigurimin e ndërveprueshmërisë me sistemet e aleatëve. Pa një plan të detajuar afatgjatë për zhvillimin e infrastrukturës dhe aftësive njerëzore,



rreziqet mbeten të larta dhe mund të pengojnë shfrytëzimin optimal të teknologjive të reja.

Për të ardhmen, ajo që do të matë suksesin ushtarak nuk do të jetë vetëm numri i njërive apo armëve, por aftësia për t'u bashkangjitur ecurisë teknologjike botërore.

Si përdoren robotët në luftën moderne?

Lufta moderne mbështetet gjithnjë e më shumë te robotët për të zgjeruar shtrirjen njerëzore, për të zvogëluar rrezikun dhe për të përsheptuar vendimmarrjen. Në të gjithë domenet ajrore, tokësore, detare dhe kibernetike, sistemet robotike kryejnë detyra që dikur kërcënonin operatorët njerëzorë ose tejkalonin qëndrueshmërinë njerëzore.

Mjete ajrore pa pilot (UAV)

Dronët e zbulimit mbajnë kamera dhe sensorë me rezolucion të lartë, duke munduruar mbikëqyrje të vazhdueshme mbi territorin armiqësor pa rrezikuar pilotët.

UAV-të e armatosura kryejnë sulme precize me ndërhyrje minimale njerëzore, duke qëndruar kot për orë të tëra dhe duke angazhuar objektiva sipas kërkesës.

Robotë tokësorë

Robotët e Asgjësimit të Municioneve Shpërthyesë (EOD) zbulojnë, identifikojnë dhe neutralizojnë minat dhe pajisjet shpërthyesë të improvizuara, duke mbrojtur ekipet e asgjësimit të bombave dhe civilët. Këto platforma përdorin manipulatore të artikuluar për të trajtuar municionet në mënyrë të sigurt.

Robotët e logjistikës transportojnë municione, furnizime dhe personel të plagosur në terren të pabarabartë, duke zvogëluar barrën fizike mbi trupat dhe duke rritur shpejtësinë e mbështetjes.

Robotët detarë

Mjetet nënujore autonome (AUV) hartëzojnë shtratin e detit, zbulojnë minat dhe mbështesin luftën kundër nëndetëseve pa rrezikuar zhytësit ose ekuipazhin.

Dronët sipërfaqësorë patrollojnë zonat bregdetare për mbikëqyrje dhe ndalim kërcënimesh, duke zgjeruar praninë detare me kosto dhe rrezik më të ulët.

Algoritmet e inteligjencës artificiale të integritit fuqizojnë navigimin autonom, njohjen e objektivave dhe parashikimin e kërcënimeve. Në Ukrainë dhe gjetkë, sistemet e drejtuara nga makina identifikojnë asetet armiqësore, hartojnë rrugë të sigurta përmes zonave të kontestuara dhe madje kryejnë taktika “të përziera”, ku dhjetëra dronë të vegjël koordinojnë sulme kundër mbrojtjes ajrore.

Robotët në role mbështetëse

Robotët e evakuimit mjekësor marrin viktimat nën zjarr dhe u sjellin module të ndihmës së shpejtë të plagosurve.

Robotët e mbikëqyrjes monitorojnë sigurinë e perimetrit në baza, duke përdorur sensorë infra të kuqe dhe akustikë për të zbuluar infiltruesit ditë e natë.

Duke ia lënë detyrat më të rrezikshme dhe monotone makinave, forcat moderne përforcojnë efektivitetin njerëzor, mbrojnë jetët dhe mbajnë operacione të vazhdueshme në mjedise të kontestuara.



Zgjidh të ardhmen tënde: Master në AFA

Akademia e Forcave të Armatosura hap aplikimet për programet e studimit Master, për vitin akademik 2025–2026.

Programet e ofruara si program I dhe II studimi janë:

- **Master Profesional në Siguri Kibernetike në fushën e mbrojtjes (25 kuota)**

- **Master Shkencor në Siguri dhe Politikë Ndërkombëtare (35 kuota)**

- **Master Shkencor në Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale (30 kuota)**

Për më shumë informacion mbi afatet e aplikimit, kriteret dhe dokumentacionin, vizitoni faqen zyrtare të AFA:

<https://afa.mil.al/njoftime/818-afatet-e-aplikimit-dhe-konkurimit-ne-3-programet-master-ne-afa-per-vitin-akademik-2025-2026>